



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 422/2 Prot.

Tiranë, më 30.05.2018

VENDIM

Nr.54, datë 30/05/2018

PËR

**MIRATIMIN E RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË MBIKËQYRJES SË
ADMINISTRIMIT TË SHËRBIMIT CIVIL NË BASHKINË PUSTEC DHE
PARALAJMËRIMIN E INSTITUCIONIT PËR TË RREGULLUAR GJENDJEN E
LIGJSHMËRISË**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me mbikëqyrjen e zhvilluar në njësinë e vetëqeverisjes vendore, Bashkia Pustec,

KONSTATOVA SE:

Me Vendimin nr. 99, datë 25.04.2017, “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në Bashkinë Pustec”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme, në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në institucionin, Bashkia Pustec.

Objekti i mbikëqyrjes është i përgjithshëm dhe përfshin veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me ligj, si pjesëmarrës në proceset e administrimit të shërbimit civil, prej momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, e në vijim.

Procesi është zhvilluar në përputhje me Programin e Mbikëqyrjes nr. 310/1 prot., datë 25.04.2017, të miratuar nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i cili me shkresën nr. 310/2 prot., datë 25.04.2017, “Njoftim për fillimin e mbikëqyrjes”, i është njoftuar Bashkisë Pustec.

Në përfundim të procesit të verifikimit të dokumentacionit dhe grumbullimit të të dhënave, grupi i mbikëqyrjes ka hartuar projektraportin për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil dhe ia ka dërguar për njohje subjektit të mbikëqyrur me shkresën nr. 422 prot., datë 25.04.2018, “Dërgohet projektraporti në përfundim të mbikëqyrjes, në Bashkinë Pustec, në lidhje me administrimin e shërbimit civil”, duke i lënë një afat **15** ditë kohë, për të paraqitur komentet e tyre në lidhje me konstatimet e evidentuara nga grupi i mbikëqyrjes.

Ndërkohë, subjekti i mbikëqyrur, pasi është njohur me materialin, nëpërmjet shkresës nr. 422/1 prot., datë 11.05.2018, “Dërgohet projektraporti i nënshkruar”, ka dërguar projektraportin e nënshkruar nga personat përgjegjës, duke qenë dakord me të gjitha gjetjet e pasqyruara në të.

Sa më sipër, çmoj se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij në lidhje me problematikën e evidentuar.

Në këto rrethana, pasi shqyrtova raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur për miratim nga grupi i punës, vlerësoj se duhet të miratoj përmbajtjen e tij.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, referuar Seksionit III, “Procedura hetimore”, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Të miratoj përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme, në lidhje me administrimin e shërbimit civil, në Bashkinë Pustec dhe të paralajmëroj institucionin për të rregulluar situatën e paligjshmërisë në zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke kërkuar zbatimin e detyrave që do të specifikohen më poshtë.

2. Me qëllim realizimin e një strukture administrative, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij, në kuadrin edhe të detyrimeve ligjore të përcaktuara në ligjin për vetëqeverisjen vendore, për të hartuar strukturën përfundimtare të bashkisë për vitin në vijim, njësia përgjegjëse e institucionit, për pozicionet e punës, të cilat nisur nga emërtesa dhe nga detyra që ato kryejnë, konsiderohen si pozicione pune pjesë të shërbimit civil, por që nuk trajtohen nga institucioni si të tillë, duhet të veprohet në këtë mënyrë:
- Njësia përgjegjëse, në bashkëpunim me strukturat e tjera administrative të ngarkuara nga ligji (*eprori direkt*), të fillojnë procedurat për rivlerësimin e statusit të pozicioneve të punës “*Specialist i Hartimit të Projekteve T.S.K.M*”, “*Specialiste për Invalidët e Punës dhe PAK në Sektorin e Kujdesit dhe Shërbimeve Sociale*” dhe “*Specialist i Turizmit dhe Kapiten Anije*”, praktikë e cila duhet të materializohet me një relacion sqarues ku rast pas rasti duhet të analizohen dhe të përcaktohen qartë funksionet që ato kryejnë, nëse janë funksione publike apo funksione të karakterit mbështetës (*punonjës administrativ*).
 - Në përfundim njësia përgjegjëse duhet të dalë me vendim të arsyetuar, mbi statusin që do aplikohet rast pas rasti për pozicionet e punës në fjalë dhe pas kësaj, duhet të rregullojë edhe marrëdhënien e punës për çdo punonjës të cilit i është rivlerësuar raporti me shërbimin civil.
 - Për pozicionet e punës që do të trajtohen si pjesë e shërbimit civil, njësia përgjegjëse në bashkëpunim me analistin e punës dhe eprorin e tij direkt, të hartojë përshkrimet e punës në përputhje me kërkesat e ligjit për shërbimin civil për të gjitha pozicionet e punës që përfshihen në shërbimin civil, duke pasur parasysh aktin nënligjor që rregullon përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës (*vendimi nr. 142/2014, i Këshillit të Ministrave “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*, i ndryshuar).

Njësia përgjegjëse, të njoftojë punonjësit që mbulojnë pozicionet e punës në fjalë dhe eprorin e tyre direkt, në lidhje me procesin e rivlerësimit dhe hartimit e miratimit të përshkrimeve të punës për këto pozicione.

3. Për nëpunësit që në momentin e mbikëqyrjes u gjenden në periudhë prove, me qëllim përmbushjen e kërkesave ligjore gjatë periudhës së provës, eprori direkt i nëpunësve dhe aktorët e tjerë që marrin pjesë në këtë proces, të respektojnë të gjitha kërkesat specifike ligjore, si dhe orientimet e përcaktuara në rubrikën nr. V, “*Respektimi i kërkesave specifike ligjore, gjatë procesit të përmbushjes së periudhës së provës*”, të Raportit. Në përfundim njësia përgjegjëse të nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të

punësim, për nëpunësit të cilët e kanë përfunduar periudhën e provës dhe janë konfirmuar nga eprori i tyre direkt.

Njësia përgjegjëse, të njoftojë të gjithë aktorët që marrin pjesë në procedurën e konfirmimit të nëpunësit në përfundim të periudhës së provës, të tillë si: eprori direkt të nëpunësit në periudhë prove, zyrtarët që marrin pjesë në vlerësimin e arritjeve në punë gjatë periudhës së provës (*zyrtari raportues, kundërfirmues e autorizues*) dhe nëpunësin më të vjetër të caktuar për të dhënë mendimin e tij me shkrim për nëpunësin në periudhë prove.

4. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **30** ditë nga marrja dijeni për këtë vendim. Institucioni i mbikëqyrur dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim duke u bazuar në orientimet e dhëna në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.
5. Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, njësia e vetëqeverisjes vendore, Bashkia Pustec, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi, duke dërguar edhe aktet administrative që provojnë masat e marra.
6. Për këtë vendim të njoftohet Kryetari i Bashkisë Pustec, duke i dërguar një kopje të raportit përfundimtar të mbikëqyrjes dhe njëkohësisht, të informohet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në Kuvendin e Shqipërisë.
7. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha